



Datë: 17.03.2025
Numër Protokolli: 3128/2025

A.nr.263/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.263/2025, të datës 03.02.2025, të parashtruar nga ankuesi Sh.E., kundër organit të punësimit: Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, me objekt ankesë “*kundërshtim i shqiptimit të masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi, 1 nën paragrafi, 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa me numër A.nr.263/2025, e datës 03.02.2025, e parashtruar nga ankuesi Sh.E.

II. Anulohet Vendimi me Nr.T-09/2025, i datës 09.01.2025 i Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës.

III. Obligohet Udhëheqësi/ja i/e Njesisë për Burime Njerëzore në Autoritetin e Konkurrencës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, ankuesit ti bëjë kompensimin e pagës së ndaluar sipas Vendimit të anuluar si në pikën II të dispozitivit dhe së masën disiplinore të anuluar më këtë vendim ta largoj nga dosja personale e ankuesit dhe regjistrat përkatës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi Civil Sh.E. (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 31.12.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar në Këshill më datë 03.02.2025, nën shenjen A.Nr.263/2025, kundër Vendimit Nr.T-09/2025, të datës 09.01.2025, të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.02.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit pranë Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, ndërsa, ky i fundit më datë 12.02.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me çështjen në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenit 129 të LPPA-së, administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 725/2025 të datës 03.02.202, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktakuzën PP.II.nr.7334/23; Raportin e shqyrtimit paraprak të hetimit në tregun përkatës të shitjeve me pakicë i datës 03.08.2023; Vendimin A.nr.210/2024 të KPMSHCK-së; Vendimin me Nr.T-09/2025, të datës 09.01.2025 të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore datës 27.09.2024; Vendimin A.nr.452/2024 të KPMSHCK-së; Opinionin për shqyrtimin e konfliktit të interesit i datës 04.09.2024 nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit për Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Emailin e datës 01.08.2023 nga ankuesi për S.B; Emailin e datës 02.08.2023 nga E.T për S.B etj; Emailin e datës 01.08.2023 nga S.B për E.T; Emailin e datës 01.08.2023 nga E.T për A.T dhe të tjerët; Emailin e datës 15.11.2024 nga ankuesi për A.T, I.H-B dhe I.Z; Emailin e datës 15.11.2024 nga A.T për ankuesin; Emailin e datës 08.08.2023 nga E.T për mbledhjen e Komisionit; Vërtetimin e datës 17.07.2023; Njoftimi i Përqendrimit i datës 18.07.2023, 19.07.2023; Raportin e përqendrimit lidhur me blerjen e aseteve i datës 01.08.2023, 03.08.2023; Emailin e datës 02.08.2023 nga E.T për S.B, ankuesin dhe R.A; Emailin e datës 02.08.2023 nga R.A për E.T; Propozim/konkluzion i datës 03.08.2023; Vendim për pushim vjetor i datës 23.08.2023; Emailin e datës 07.08.2023 nga R.K, për ankuesin I.Z, E.T, R.Z dhe S.B; Foto; Komunikim telefoni; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 07.02.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 12.02.2025; Akt Emërimit e datës 27.05.2013 për ankuesin; Përshkrimin e detyrave të punës Inspektor Hetues i Konkurrencës; Vendimin e datës 26.11.2024 nga Komisioni Disiplinor për shtytje të afatit për vendosje; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 18.11.2024; Emailin e datës 21.08.2023 nga ankuesi për I.Z.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur së ankesa është e bazuar, ***sepse:***

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave materiale të lëndës ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Autoritetin e Konkurrencës gjegjësisht i njëjti sipas Akt Emërimit, me numër protokollit 106/13 të datës 27.05.2013, mbanë pozitën “*Inspektor për Hetimet e Shkeljeve të Konkurrencës në Treg*”, ndërsa, sipas Vendimit nr.50/20223 të datës 16.05.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, ankuesi është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut dhe se i njëjti vazhdon të ushtroj këtë pozitë.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton, se më 30.01.2024, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës përmes shkresës zyrtare me numër të protokollit 54/24-06/B, ka shqiptuar ndaj ankuesit në pozitën e u.d. Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut masën disiplinore “*vërejte me shkrim*”.

Ankuesi kundër kësaj mase disiplinore ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 13.02.2024, ndërsa, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më Vendimin A.nr.210/2024 të datës 29.03.2024, ka shfuqizuar masën disiplinore vërejtje me shkrim me numër protokollit 54/24-06/B të datës 30.01.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë.

Në kuadër të zbatimit të Vendimit A.nr.210/2024 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, më datë 27.09.2024, ka parashtruar kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit pranë Komisionit Disiplinor, për shkelje të rënda disiplinore me arsyetimin se ka shkuar në pushim vjetor prej 18 ditësh pa aprovim dhe miratim të mbikëqyrësit të tij; ka neglizhuar kryerjen e detyrave të punës; neglizhim dhe mos kryerje e detyrave të punës; tejkalim i kompetencave; mos respektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; veprimet apo mos veprimet që kanë shkaktuar pasoja lidhur me vonesat në shqyrtim, vlerësim dhe përfundim të rasteve.

Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Konkurrencës më Vendimin Nr. T-09/2025, të datës 09.01.2025, ka aprovuar pjesërisht kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 27.09.2024, duke shqiptuar ndaj të njëjtit masën disiplinore *ndalimi prej njëzet për qind (20%) i pagës bazë për periudhën gjashtë (6) mujore*, dhe atë duke filluar nga data 01.02.2025.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit Nr.T-09/2025, të datës 09.01.2025 të Komisionit Disiplinor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, duke pretenduar se ky vendim është në kundërshtim me dispozitat ligjore sepse ka aplikuar akte nënligjore që nuk kanë qenë në fuqi për kohën që ka konsideruar shkelje disiplinore; shton se në këtë procedurë iniciuesi i procedurës është në konflikt interesi më të; për pushimin vjetor për periudhën 01 deri me 18.08.2023 ka njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, dhe se ka lënë edhe zëvendësuesin dhe për këtë çështje është vendosur sipas Vendimit A.nr.452/2024. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet vendimi i kontestuar me ankesë.

Kolegji i Këshillat në kuptim të pretendimeve ankimore analizoj aktin e kundërshtuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të çështjes, dhe si rrjedhojë konstatoi se Komisioni Disiplinor duke vepruar sipas kërkesës së datës 27.09.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKK-së, ka aprovuar pjesërisht kërkesën e datës 27.09.2024, për iniciim të procedurës disiplinore duke mos specifikuar se në cilën pjesë refuzohet kërkesa dhe në cilën pjesë aprovohet, dhe mbi cilat fakte ka bërë refuzimin/aprovimin, si dhe duke dhënë konstatim të përgjithshëm se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë, duke mos identifikuar gjegjësisht pa dhënë kualifikim ligjor të shkeljes. Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor me aktin e goditur më ankesë ka konstatuar se ankuesi në atë periudhë si u.d. Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrës së Tregut, ka vajtur (shkuar) në pushim vjetor nga data 01.08.2023 deri me 18.08.2023, pa aplikuar në SIMBNJ dhe pa marrë aprovim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, siç e përcakton Rregullorja Nr.04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik. Më këtë veprim nëpunësi civil Sh.E. ka kryer shkelje të e rëndë sipas Ligjit për zyrtaret Publik....”.

Në kuptim të përgjegjësisë së ankuesit lidhur me shkuarjen në pushim vjetor pa aprovim të mbikëqyrësit të tij drejtpërdrejt, Kolegji bazuar në provat e lëndës ka gjetur së ankuesi për periudhën kohore nga data 01 deri me 18 gusht 08.2023, ka qenë në pushim vjetor, dhe së qëndron fakti së ankuesi nuk kishte bërë kërkesë për pushim në SIMBNJ, mirëpo, ankuesi në pozitën e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit për Mbikëqyrje të Tregut, përmes emailit të datës 01.08.2023, ka njoftuar Drejtorin e Përgjithshëm në cilësi të mbikëqyrësit se gjendet në pushim deri me datë 20 gusht dhe së do e zëvendësoj zyrtari E.T. Pra, mbikëqyrësi i ankuesit ka qenë në dijeni me pushimin e ankuesit dhe së në provat e lëndës nuk ka ndonjë dëshmi që vërteton faktin së Drejtori i Përgjithshëm në atë kohë ishte përgjigjur ndaj ankuesit me refuzim të pushimit apo të ketë shprehur ndonjë reagim në raport me emalin e ankuesit të datës 01.08.2023. Kështu që, në këto rrethana, mos reagimi i mbikëqyrësit mund të nënkuptohet edhe aprovim në heshtje i pushimit të ankuesit. Gjegjësisht, nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesi pas kthimit nga pushimi vjetor, më datë 21.08.2023 ka parashtruar kërkesë përmes SIMBNJ për pushim vjetor të shfrytëzuar e të cilën kërkesë e ka miratuar Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore, më mbishkrimin që aprovimi bëhet sipas emailit të datës 21.08.2023. Andaj, nisur nga kjo gjendje e fakteve, në vlerësimin e Kolegjit në veprimet e ankuesit nuk manifestohen elemente të kryerjes së shkeljes së rëndë disiplinor lidhur me vijueshmërinë dhe mungesat në punë.

Marr parasysh se shkelja disiplinore për të cilën ankuesi është shpallur përgjegjës, i referohet periudhës 01 deri 18 gusht 2023, rezulton fakti së Komisioni Disiplinor gabimisht i është referuar bazës ligjore më rastin e vendimmarrjes në ketë çështje disiplinore, pasi që në ketë periudhë kohore ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-116 për Zyrtarët Publikë (i aplikueshëm nga data 09.07.2020 deri me 25.09.2023) dhe Rregullorja(QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik (në fuqi nga data 13.10.2022 deri më 22.08.2024).

Andaj, nisur nga konstatimet dhe rrethanat si më sipër, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së akti i goditur më ankesë, konkretisht Vendimi Nr.T-09/2025, i datës 09.01.2025, i Komisionit Disiplinor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, është akti i nxjerr më vërtetim jo të drejt të gjendjes faktike dhe zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale, dhe mbi ketë bazë, akti i kontestuar konsiderohet si akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Rrjedhimisht, Kolegji më qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, e në kuptim të autorizimeve ligjore sipas nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, aprovoj ankesën në tërësi si të bazuar, anuloi aktin e kontestuar dhe obligoj Udhëheqësin e Njesisë për Burime Njerëzore në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës sikurse në pikën III të dispozitivit.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.263/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Sh.E.;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe
Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin Kosovare të Konkurrencës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.